



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 997 Prot.

Vlorë, më 22.01. 2025

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ 2025

**“PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR NDERI I VLORËS “Z. PIRO  
BREGAJ”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8 pika 2, pika 9.1, pika 1.1./b dhe pika 7/a, neni 54 pika m; në ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 14, neni 15, pika 1/a dhe 2/b, neni 16, Ligji Nr 94/2022 datë 22.12.2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit”, me propozim të kërkeses nr 420 Prot, datë 13.01.2025, të Shoqatës Shkrimtarëve dhe Artistëve “Petro Marko” Vlorë dhe Shoqata “Kanina” të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimin Nr. 1 datë 21.01.2025, si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 28.01.2025

**VENDOSI:**

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi i Vlorës” Z. Piro Bregaj, me këtë motivacion:  
**“Për Veprimtarinë e gjërë në ruajtjen e traditave, kulturës dhe polifonisë Labe”.**
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.



**KRYETAR**  
**Ermal Dredha**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 997 Prot.

Vlorë, më 22.01. 2025

**RELACION**

**MBI PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI I VLORËS Z. PIRO BREGAJ”**

**Para Këshillit të Bashkisë Vlorë**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Ju paraqesim për miratim Projektvendimin “Për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” z. Piro Bregaj” i cili është një propozim i “Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve” Petro Marko Vlorë”. Ky propozim është kërkuar të vlerësohet nga Këshilli i Bashkisë për këtë personalitet të shquar, i cili ka dhënë kontribut të spikatur veçanërisht në fushën e kulturës. Ai ka një kontribut të shquar në rrafshin shoqëror, si ruajtës i vlerave dhe traditës kulturore të Vlorës, si edhe pjesëmarrës aktiv në gjallërimin e jetës artistike në Vlorë, duke qenë iniciator i aktiviteteve kulturore dhe atdhetare të qytetit.

Është për t’u theksuar se marrëdhëniet dhe interesimi i tij për qytetin e Vlorës kanë qënë të vazhdueshme gjatë gjithë karrierës së tij.

Për të mos u zgjatur në vlerat që mbart ky personalitet i shquar, bëshkëlidhur këtij projektvendimi mund të gjeni dhe përshkrimin e karrierës së tij në propozimin e bërë nga Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve “Petro Marko” Vlorë.

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim, si një vlerësim për këtë personalitet të shquar të qytetit të Vlorës.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

Nr. 975 prot.

Vlorë, më 21.01 2025

**VENDIM**  
Nr. 1 . Datë 21.01 .2025

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, Pranë Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhje e datës 21.01.2025, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura;

**VENDOSI:**

Të miratojë propozimet e paraqitura si më poshtë:

1. Emërtim sheshi në qytet me emrin “Flamurtari”
2. Vlerësim me titullin “Qytetar Nderi” Z. Pirro Bregaj.

Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për procedurat e mëtejshme ligjore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

**KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR**

**Bardhosh Gaçe**